

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS, LIDHUR ME SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “HPG ENERGY” SHPK, PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a”, dhe 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.8.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1724/1 prot., datë 7.8.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘HPG Energy’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “HPG Energy” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1724 prot., datë 2.8.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik, me kapacitet të instaluar 2mw dhe veprave ndihmëse, në Njësinë Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në pikën 1.1, gjerat: “a” “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gjerat: “a”, “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, gjerat “a” dhe “c”; për pikën 2.1, gjerat: “b”, “d”, “e” dhe “f”.

- Rezulton se shoqëria “HPG Energy” sh.p.k.:

- Ka nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) kontratën me nr. 1961 rep., nr. 1269 kol., datë 6.4.2023, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet prodhues 2 mw dhe veprave ndihmëse, në zonën kadastrale 3358, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier, nga shoqëria ‘HPG Energy’ sh.p.k.”;

- Ka marrë ofertën për rimiratimin e pikës së lidhjes me rrjetin e shpërndarjes nga shoqëria “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” (OSSH) sh.a., nëpërmjet shkresës së kësaj të fundit nr. 2293/1 prot., datë 15.7.2024;

- Është pajisur me vendim për VNM-në paraprake, lëshuar më datë 18.7.2024, nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për të ndërtuar impiantin fotovoltaiik me fuqi 2 mw;

- Nga ky aplikim nevojitet të plotësohet informacioni/dokumentacioni në vijim:

Neni 9

Pika 1. Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë

Pika 1.3:

- germa “b”: Shoqëria duhet të depozitojë dokumentacion vërtetues për disponimin e fondeve për realizimin e investimit sipas kontratës me MIE-n, duke iu referuar mënyrës së financimit të parashikuar në planin e saj të biznesit.

Pika 2, Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës

Pika 2.1:

- germa “a”: Shoqëria duhet të depozitojë dokumentacionin teknik mbështetës, në lidhje me jetëgjatësinë e pritshme të centralit fotovoltaiik;

- germa “b”: Shoqëria duhet të depozitojë informacion/dokumentacion, në lidhje me zbatimin e afateve të kontratës së nënshkruar MIE-n;

- germa “c”: Shoqëria duhet të depozitojë në ERE rimiratimin final/marrëveshjen e nënshkruar me “OSSH” sh.a., për pikën e lidhjes.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “HPG Energy” sh.p.k në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 2 mw dhe veprave ndihmëse, në Njësinë Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “HPG Energy” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti